



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, *Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:*

Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Titulli i punës:	Anketues/Intervistues për Anketën mbi përdorimin e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit(TIK) 2019
Numri i referencës:	ASK-DSS-001
Tarifa e shërbimit:	I negociuar
Raporton te:	Zyra rajonale e Prizrenit / njësia e standardit jetësor në ASK
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta-(MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	1 muaj
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i intervistuesve:	ASK-2

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të marrin pjesë në trajnime dhe të njihen me udhëzimet metodologjike dhe organizative përfshirë pyetëtorin e ekonomisë familjare, dhe të jenë të përgatitur për të praktikuar në terren bazuar në udhëzimet për anketën e përdorimit të Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit - TIK;
- Të zhvillojnë grumbullimin e të dhënave për anketën e TIK me metodologjinë CAPI (përmes tabletit);
- Të bëjnë identifikimin e ekonomisë familjare duke u bazuar në listat e ekonomive familjare dhe në harta si dhe të respektohet kriteri për individët për moshën 16 deri 74 vjeç;
- Të respektoj udhëzimet e pyetëtorit për pyetjet që nuk duhet t'i parashtrijnë disa të anketuarve dhe të ndjekin të gjitha procedurat dhe sqarimet e përshkruara në udhëzime;
- Para largimit nga ekonomia familjare bënë kontrollimin e pyetëtorit të plotësuar për t'u siguruar se të gjitha pyetjet janë plotësuar dhe të gjitha udhëzimet janë ndjekur;
- Rishqyrtimi për të intervistuar ekonomitë familjare të cilat nuk mund të intervistohen gjatë vizitës së parë;
- Përdorimi i adresave dhe hartave për qarqet regjistruese dhe ekonomitë familjare të caktuara;
- Të njoftojnë mbikëqyrësit për problemet dhe pasiguritë e mundshme dhe të kërkojnë ndihmë nëse është e nevojshme;
- Intervista zhvillohet në gjuhën të cilën e flasin ai komunitet.
- Të bëjnë raportimin javor te mbikëqyrësi;
- Të përfundojë anketa e ekonomive familjare dhe Individëve brenda afatit të përcaktuar;
- Të mbajë të gjitha informatat e pranuar në familjet e anketuara si sekret zyrtar;
- Të kthejë materialet dhe pajisjet e pranuar nga ASK (hartat dhe listat e ekonomive familjare), pas përfundimit të punës në teren.

Përgatitja shkollore dhe përvoja:

- Të kenë të kryer të paktën shkollën e mesme;
- Të kenë përvojë pune (e preferuar përvoja në anketa);

Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi dhe bashkëpunim shumë të mirë për të komunikuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Aftësi të orientimit në hapësirë (përdorimi i hartave në hapësirë për identifikimin e objekteve të banimit);
- Aftësi kompjuterike, Word, Excel, internet etj;
- Të jetë nga rajoni përkatës ku do të zhvillohet anketa e TIK.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Konkursi është i hapur 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Web-faqen e ASK-së.

Numri i anketuesve/intervistuesve sipas etnitetit dhe regjionit:

Regjioni	Anketues shqiptarë
Prizren	2

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Arkivin e ASK-se, ose mund të shkarkohet nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/> Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr, "Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: CV¹, kopja e letërnjoftimit, dokumenti mbi vendbanimin, diploma e shkollës së mesme (të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje). Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen intervistës me gojë.

Për informata më të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038-200 31 149 apo 038-200 31 151 prej orës 08:00 – 16: 00.

¹ Përfshirë: Nr. e telefonit si dhe një adresë elektronike

